KOMUNIKATË PËR WEB

Takim me përfaqësuesin e UNDP-së, z. Nuno Queiros – Regjistrimi i Popullsisë, Ekonomive Familjare dhe Banesave

15.12.2023

Në ambientet e Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK) u mbajt takim me përfaqësuesit UNDP-së, z. Nuno Queiros (udhëheqës i zyrës për Kosovë) dhe znj. Valbona Bogujevci (asistente dhe koordinatore e projekteve).

U.d. Kryeshefit Ekzekutiv të ASK-së, z. Avni Kastrati, i cili i njoftoi përfaqësuesit e UNDP-së me procesin dhe sfidat e Regjistrimit të Popullsisë. Ndër pikat kryesore që u diskutuan ishin: Rekrutimi i regjistruesve dhe mbikëqyrësve, takimet për Fushatën sensibilizuese dhe Anketën pos regjistruese.

Z. Queiros tha se UNDP mund të ndihmojë me angazhimin e një numri të caktuar të stafit përmes rrjeteve të tyre.

Në takim u ngrit për diskutim edhe çështja e mbështetjes profesionale, që mund të mbështet UNDP.

Organizmi i takimeve të rregullta për t'u njoftuar me procesin e Regjistrimit, u pa si një instrument i koordinimit dhe bashkëpunimit në të ardhmen.